



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA CËRRIK

Data: 05.06.2025

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: *“Punime ndertimi per rikonstruksionin e katit Perdhe te ish shkolles "Liria" per adaptimin e ketij kati ne qender Multifunksionale”*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Punime ndërtimi për ndërtesa multifunksionale 45211350-7**

VLERA E FONDIT LIMIT: **2492984** (dy milion e katerqind e nentdhjete e dy mije e nentqind e tetedhjete e kater) Leke pa tvsh.

Perllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike eshte kryer nga inxhinier i bashkise referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj”, **Inxhinieri është mbështetur ne manualin teknik te çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar ne ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e koston së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. me qëllim që vlere limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia CERRIK** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

Argumentimi:Ky kriter u vendos me mbështetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale

Sipas kritereve te pergjithshme te perzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kesaj shtojce .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës se fondit limit qe prokurohet.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. *Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *Ne lidhje me situaten ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojme qe operatoret ekonomike kane kapacitetin e nevojshem ekonomik dhe financiar per te zbatuar kontraten”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”, si dhe bazuar ne nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë 41.Riformeluar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021 43 Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021 46 intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme44 . 3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autori. Vendosija e ketij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qellim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur/ fondit limit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për*

tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit **(2022, 2023, 2024)**, të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është ne kushtet e parashikuara nga neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet te shoqerohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë per kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenin 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “ Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” dhe nenin 29, pika 1, të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2024**, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës perkatese te DST, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dheneni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **30%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se **dyfishi i vlerës limit të kontratës** që prokurohet (*pa TVSH*).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:

1. Kontratën e Sipërmarrjes,
2. Situacionin përfundimtar të objektit dhe situacionet progresive/pjesore
3. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor
4. Aktin e Kolaudimit të objektit
5. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit
6. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës
7. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

- ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratën e Sipërmarrjes,
2. Situacionin përfundimtar të objektit
3. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor
4. Aktin e Kolaudimit të objektit
5. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit
6. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e

mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se disponon liçense profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 "*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*", i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**
 - **N.P-3** (Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada,) **Niveli A**
 - **N.P-12** (Punime të inxhinjerise së mjedisit) **Niveli A**
- **Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**
 - **N.S – I** (punime për prishjen e ndertimeve) **Niveli A**
 - **N.S.-14** (Impiante të brendshme, elektrik,) **Niveli A**
sipas modelit të lëshuar nga MPPT;

Operatorët ekonomikë duhet të kenë liçencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë ata duhet të paraqesin liçencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat për dhënien e liçensave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimore".

Operatorët e huaj duhet të barazvlerësojnë (ekuivalentojnë) liçencat profesionale që ata kanë lëshuar nga vendi i origjinës, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrinë kompetente) në Republikën e Shqipërisë. (Rregullore për kriteret dhe procedurat për lëshimin e liçensave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, miratuar nga VKM, Nr. 42, datë 16.01.2008).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, "Për

miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 8 përcakton "Zbatimi I punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, private ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

<i>Kategoria e kërkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</i>	<i>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>	<i>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive</i>	<i>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>
Kategoria NP- 3A	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada	Rikonstruksion i godines se qendres multifunkionale Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.	A	0-20 milion
Kategoria NP-12	Punime te inxhinierise se mjedisit	Sipas percaktimeve ne preventiv.	A	0-20 Milion
Kategoria NS- 1A	N.S – 1 Punime për prishjen e ndërtimeve.	2.430/3 Prishja e rrjetit ekzistues elektrike 2.430/4 Prishja e rrjetit ekzistues hidraulik 2.310/2 Prishja e suvase se brendshme 2.310/2 Prishja e suvase jashte 2.426 Prishje mur tulle per bashkim zyra dhe formatim dritare	A	0-20 milion
Kategoria NS-14 A	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV	2.480/3 F.V tub plastmasi Ø 22 ~ 26 mm 2.487 F.V Kutiderivacioni plastike An 10 FV Kabell Bakri 3x2.5mm ² An 11 FV Kabell Bakri 3x4mm ² An 12 FV Kabell Bakri 5x10mm ² 2.487/c F.V kuti suport	A	0-20milion

		pllaket 2 modular Gevis 2.485/d F.V priza shuko "Gevis" universal 2.485/2 F.V Çeles 1 polar 220V 10A "Gevis" An 13 FV Prize Data/Telefoni RJ 45 cat5e FTP 2.490/1c F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 32A 2.490/1b F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A 2.490/d F.V Kasete plastike KE me 12 modular (vende) 2.490/1e F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 63A 2.549 Kontator magnetik,220V,40A 2.549 Ndricules fluoreshent 4x18w,IP40(60cmx60cm) 2. 468 Ndricules plafoniere brace 1x40W(tualet dhe ambienti sanitar) 2.496 Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m 2.481/5 F.V percjelles PV- 500 Ø 10 mm2 i zhveshur 2.503 Percjelles shirit zinku tokezimi, Zn= 30x3mm		
--	--	--	--	--

2.3.3. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- i. Libreze pune (përkatëse)
- ii. C.V (përkatëse)
- iii. Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)
- iv. Diplomë

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të

kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: Lidhur me kërkesën që Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paafësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

2.3.4 Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, çertifikimet, i kualifikuar për keto punime:

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:

- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Ndërtimi**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Elektrik**

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës perkatese të DST, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.

OE duhet të paraqesë dokumentacionin sipas kërkesave të mëposhtme:

- Stafi teknik i sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për për te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme), librezë pune, C.V.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.4.1. Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Minimuni 1 (një) **Inxhinier mekanik**
- Minimuni 1 (një) **inxhinier Mjedisi**

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës perkatese të DST, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe C.V.

Argumentimi :Kërkesat e mësipërme janë vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin Teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin Teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Në Kreun IV të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 1 “Drejtuesi teknik i shoqërisë”, gërma b) parashikohet: “Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të komisionit për dokumentacionin e paraqitur. Përcaktimi i kërkesës për Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt garanton autoritetin jo vetëm për angazhimin tere kohen e kryerjes se punimeve te nje drejtuesi teknik te shoqerise por dhe si orientim per nje person kontakti dhe ure lidhese mes mbikqyresit te punimeve dhe AK per problematiken qe do te haset gjate realizimit te punimeve.

Inxhinier ndertimi – është i domosdoshem për të ndjekur punimet e ndertimit që përcaktohen në preventivin fillestar e perkatesisht ne zerat:

2.86	Ndertim mur tulle t=12 ne tualete ne lartesi 2.3m dhe formatim dritare
2.3	Suva solete ~ 4 m me drejtues, me krah brenda
2.310	Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25
2.277	Shtrese lluster çimento 1:2, t=30mm

Inxhinier elektrik – Eshte i domosdoshem për të ndjekur punimet elektrike që përmban preventivi fillestar e perkatesisht ne zerat :

	Punime Elektrike
--	-------------------------

2.480/3	F.V tub plastmasi Ø 22 ~ 26 mm
2.487	F.V Kutiderivacioni plastike
An 10	FV Kabell Bakri 3x2.5mm ²
An 11	FV Kabell Bakri 3x4mm ²
An 12	FV Kabell Bakri 5x10mm ²
2.487/c	F.V kuti suport pllaket 2 modular Gevis
2.485/d	F.V priza shuko "Gevis" universal
2.485/2	F.V Çeles 1 polar 220V 10A "Gevis"
An 13	FV Prize Data/Telefoni RJ 45 cat5e FTP
2.490/1c	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 32A
2.490/1b	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A
2.490/d	F.V Kasete plastike KE me 12 modular (vende)
2.490/1e	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 63A
2.549	Kontator magnetik,220V,40A
2.549	Ndricues fluoreshent 4x18w,IP40(60cmx60cm)
2. 468	Ndricues plafoniere brace 1x40W(tualet dhe ambienti sanitar)
2.496	Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m
2.481/5	F.V percjelles PV-500 Ø 10 mm ² i zhveshur
2.503	Percjelles shirit zinku tokezimi, Zn= 30x3mm

Inxhinier mekanik – Eshte i domosdoshem per te ndjekur punimet mekanike e perkatesisht ne zerat:

An	F.V. Kabllo alarmi zjarri me izolim PVC, tip RG-59 S=2x1.5mm ² , red colour per loop-in te detektoreve
An	F.V. Kabllo tip FTG10(O)M1, S=2x1.5mm ² me rezistence ndaj zjarrit deri 3ore, per loop-in te sirenave
480/1	F.V. Tub PVC fleksibel vetshuares (d 13) dj = 16m/m
An	F.V. Detektore tymi/temperature, optik multi sensitiv, me modul komunikimi, tip inteligjent I adresueshem
An	F.V. Sirena alarmi zjarri, me ndricues me llambe vezulluese, per vendosje ne ambient te brendshem, tip inteligjent te adresuesheme, me intesitet 120dB.(nje ne arzhive)

Inxhinier mjedisi - është përgjegjës për mbarratjen e të gjitha punimeve dhe sigurimin që punimet e kryera mos cenojnë kushtet dhe parametrat mjedisore të terrenit dhe të kënaqësisë sa më të vogël në mjedis.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

- 1(nje)** person, pjesë e stafit të shoqërisë, duhet të jenë të pajisur me certifikatën e Trajnimit për *"Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në Pune"*, *"Përgjegjës për sigurinë"*, e dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj,
- Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij, **1(nje)** person të certifikuar për *"Ndihmen e parë dhe ndërhyrje ndaj emergjencave"*, të cilët duhet të figurojnë në listepagese minimalisht për 3 (tre) muajt e fundit).

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës perkatese të DST, "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për *Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010,

“Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” rekomandohet të jete ne kantier ne rast aksidentesh ne pune.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **25 (njezete e pese) punonjës** për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës perkatese në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës perkatese te DST, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provues.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimi. Autoriteti kontraktor në përcaktimin fuqisë punëtore te nevojshme për realizimin e kontratës ka bërë një përllogaritje të saktë të numrit të punonjësve duke përcaktuar fillimisht orët e punës në bazë të analizës sipas manualit të çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” Në këtë kontekst, autoriteti kontraktor ka përcaktuar numrin e punonjësve referuar një përllogaritje të saktë të bërë referuar zërave të punimeve per objektin e prokurimit, orëve të punës (8 ore ne dite për cdo punonjës) afatit kohor te realizimit te kontrates (30 dite)si dhe shperndarjes se punes.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si dhe të përfshirë në listepagesa për periudhën 3 muajt e fundit, me profesionet si mëposhtë:

Lloji i Specialistit	Numri i kerkuar
• Teknik Ndertimi	1
• Specialist duro/alumini	1
• Elektracist	1
• Specialist ngrohje-ftohje (kondicionimi)	2
• Hidraulik	1
• Specialist ndertimi	2

Krahas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese në DST, për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1.				
2.				
etj.				

* Disponimi i stafit/ punonjësve sipas specialitetit të kërkuar, duhet të deklarohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: Për specialistët e sipercituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten, deshmite/certifikatat ose cdo dokument tjetër që verteton diplomimin/trajnimin/ose kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme.

- Kontrata e punës e vlefshme,
- Dëshmi/ certifikatë kualifikimi të lëshuara nga institucione publike/ private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” për specialistët, ndërsa për teknikët duhet të paraqiten diplomat e shkollës së mesme/ ose te larte,
- Secili specialistë i sipercituar sipas profesioneve, duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit, nga data e zhvillimit të tenderit.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi 2 (dy) shoferë të mjeteve të rënda/kamioni dhe 2 (dy) automakinistë, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën 3 muajt e fundit në rastin kur mjetet/makineritë e deklaruar janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me

qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, **dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:**

- Kontratë pune të vlefshme,
- Dëshmi kualifikimi nga organet përkatëse sipas ligjit,
- Për stafin manovratorë/automakinist të paraqiten: Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor;

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës., të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

- Teknik Ndertimi 1 – është i domosdoshem për të ndjekur punimet e ndërtimit të parashikuara në preventivin fillestar e perkatesisht në zerat: Ndërtim mur tulle t=12 në tualete në lartësi 2.3m dhe formatim dritare , Suva solete ~ 4 m me drejtues, me krah brenda, Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25
- Specialist duro/alumini 1 – është i domosdoshem për të kryer punimet e percaktuara në preventivin fillestar e perkatesisht në zerat: Dritare d/alumini dyfi xh., Dyer d/alumini dyfi xh, F V dyer të brendeshme druri importi cilesi e I-re.
- Elektracist 1 – është i domosdoshem për të kryer punimet eektrike të percaktuara në preventivin fillestar e perkatesisht në zerat:

2.480/3	F.V tub plastmasi Ø 22 ~ 26 mm
2.487	F.V Kutiderivacioni plastike
An 10	FV Kabell Bakri 3x2.5mm ²
An 11	FV Kabell Bakri 3x4mm ²
An 12	FV Kabell Bakri 5x10mm ²
2.487/c	F.V kuti suport pllaket 2 modular Gevis
2.485/d	F.V priza shuko "Gevis" universal
2.485/2	F.V Çeles 1 polar 220V 10A "Gevis"
An 13	FV Prize Data/Telefoni RJ 45 cat5e FTP

2.490/1c	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 32A
2.490/1b	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A
2.490/d	F.V Kasete plastike KE me 12 modular (vende)
2.490/1e	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 63A
2.549	Kontator magnetik,220V,40A
2.549	Ndricues fluoreshent 4x18w,IP40(60cmx60cm)
2. 468	Ndricues plafoniere brace 1x40W(tualete dhe ambienti sanitar)
2.496	Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m
2.481/5	F.V percjelles PV-500 Ø 10 mm ² i zhveshur
2.503	Percjelles shirit zinku tokezimi, Zn= 30x3mm

• Specialist ngrohje-ftohje (kondicionimi) 2- eshte i domodoshem per te kryer punimet si:
An "F.V. Kabllo alarmi zjarri me izolim PVC, tip RG-59 S=2x1.5mm², red colour per loop-in te detektoreve"

An F.V. Kabllo tip FTG10(O)M1, S=2x1.5mm² me rezistence ndaj zjarrit deri 3ore, per loop-in te sireneve

480/1 F.V. Tub PVC fleksibel vetshuares (d 13) dj = 16m/m

An F.V. Detektore tymi/temperature, optik multi sensitiv, me modul komunikimi, tip inteligjent I adresueshem

An F.V. Sirena alarmi zjarri, me ndricues me llambe vezulluese, per vendosje ne ambient te brendshem, tip inteligjent te adresuesheme, me intesitet 120dB.(nje ne arzhive)

• **Hidraulik 1- eshte i domosdoshem per te kryer punimet hidraulike si:**

1	2.613	Hapje vrimash ne solete deri ne Ø 200 mm
2	2.491/a	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=20mm, t = 2.0 mm, PN 10
3	2.491/b	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=25mm, t = 2.0 mm, PN 10

4	2.491/c	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=32mm, t = 2.4 mm, PN 10
5	2.An - 9	F.V Saraçineske PPR 1/2"
6	2.An - 10	F.V Saraçineske PPR 3/4"
7	An.14	Bashkues me fileta d=20mm
8	An.15	Bashkues me fileta d =25mm
9	An.16	Bashkues me fileta d=32mm
10	An.17	Bryla me filata me fileta d=20mm
11	An.18	Bryla me fileta d =25mm
12	An.19	Bryla me fileta d=32mm
13	An.20	Tre degesh me filata me fileta ø32 me ø20mm
14	An.21	Tre degesh me fileta ø32mm me ø25mm
15	An.22	Tre degesh me fileta ø20mm
16	An.23	Kundra valvol ø 32mm
17	An.24	Hollandez ø 32mm
18	2.494/3	F.V saracineska bronzi Ø 1 1/4 " = 32 mm
		Shuma A
		B.Shkarkimi I Ujrave
1	An	Cpim solete monolite me trashesi 20cm
2	2.520	Tub kanalizimi pvc Ø 110 mm
3	An.25	Tub kanalizimi pvc Ø 50 mm
4	2.516	Tuba pvc dhe rakorderi
5	2.515	F.V pilete dysHEMEJE Ø 50 mm
6	An.26	F.V WC allafrenga importi + mishelator
7	2.506	F.V bide importi porcelani

8	2.495	F.V lavaman porcelani importi me mishelator
---	-------	---

- **Specialist ndertimi 2- jane te domosdoshem per te kryer punimet e ndertimit si:**

2.281	Heqje pllaka granili ne dysHEME e shkalle
2.43	Heqje nenshtresa e mbushje poshte pllakave
2.603	Heqje plintusa
2.370/1	Heqje dYer dhe dritare
2.608	Heqje dYer metalike me hyrje te katit pare
2.430/3	Prishja e rrjetit ekzistues elektrike

Manovratorët dhe shoferët janë të nevojshëm për shkak të makinerive të ndryshme si kamion, vinc që do të kryejnë punime të percaktuara në preventiv.

- 2.3.9** Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit):

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pesë) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion)	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë (kapaciteti mbajtës deri në 2(dy) ton për secilin kamionçinë)	4 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinc	1 copë	Pronësi ose me qera
RTV Rimorkiator ose Karrotrec	1 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	2 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator	1 cope	Pronesi ose me qera
Prozhektore kantieri	2 copë	Pronësi ose me qera
Gjeneratore	1 copë	Pronësi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 30copë
- Ripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 10copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5copë
- Uniforma/Jelek pune 30cope
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15copë

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës perkatese te DST, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si më poshtë:

- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).
- b) Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, certifikatë për transport mallrash (e vlefshme).
- c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas Deklaratës se shoqërisë ofertuese.
- f) Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës.

2.3.10 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 9001:2015 (për sistemin e menaxhimit të cilësisë)**, e vlefshme,
- Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 14001:2015 (për sistemin e menaxhimit të mjedisit)**, e vlefshme,
- Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 45001-2018 (për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)**, ose certifikaten ekuivalente, e vlefshme,

Ne rastin e bashkimit të perkohshëm të shoqërive secili operator duhet të paraqesë certifikatat e mesiperme, në varesi të punimeve që do të marri persiper konform marrëveshjes.

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kërkesa për keto certifikata është bere pasi janë të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

ISO 9001:2015 - Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi , e cila mundeson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës.

ISO 45001: 2018 – Sistemi i manaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës mundeson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

ISO 14001-2015- Është standarti më i përdorur në botë për sistemet e menaxhimit të mjedisit. Rikonstruksioni i objektit konkret, përveçse kërkon një kapacitet me makineri kanë edhe një ndikim në mjedis për shkak të kushteve në të cilat realizohen si ndotja e ajrit nga pluhurat e kantierit ndotja akustike dhe mjedisore nga makinerite etj, aq me teper qe kemi te bejme me dy objekte brenda ne qytet. Për këtë arsye cdo operator ekonomik duhet të jetë i certifikuar për menaxhimin e ambientit. Është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të dorezojë **Grafikun e punimeve** në përputhje me zërat e punës të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit, kjo në respektim të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.12 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **deklaratën** ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik” dhe nenit 78 pika 2 e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Specifikimet teknike janë hartuar nga inxhinier i bashkise dhe do të bashkengjiten dokumentave të tenderit në SPE.

NJESIA E PROKURIMIT
